

**KONTRATË
PËR
SHIT-BLERJEN E KUOTAVE**

Sot më 02/07/2008, në Tiranë, Shitësi dhe Blerësi, përfunduan këtë kontratë për transferimin dhe blerjen e kuotave, sipas kushteve dhe termave të mëposhtme:

*Shoqëria Tregtare **STARLED LTD**, shoqëri e organizuar dhe themeluar sipas së drejtës angleze, e regjistruar me seli zyrtare në adresën: Chambers, 197 Main Street, P.O. BOX 3174, Road Toën, Tortola, Ishujt British Virgin*

Këtej e tutje në këtë kontratë me emrin Blerësi

DHE

***Z. Gani HOXHA**, shtetas shqiptar, me vendbanim në Shqipëri, Tiranë, me adresë Rruga "Karl Gega", Pall 3/1, Ap 16, Shk.1, madhor dhe aftësi për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. Z.1950841, i cili vepron në këtë kontratë së bashku me bashkëshorten e tij **Z. Natasha HOXHA**, shtetase shqiptare me të njëjtin vendbanim,*

Këtej e tutje në këtë kontratë me emrin Shitësi

Palët ranë dakort të nënshkruajnë këtë kontratë për transferimin e kuotave, sipas së drejtës Shqiptare.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Objekti i kontratës**

- 1.1. Kjo është një kontratë për transferimin dhe kalimin e masës prej 35% të kuotave që shitësi zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "RA KROM-TIRANA" SH.P.K, tek Blerësi në përputhje me kushtet dhe termat e kësaj kontrate dhe me çmimin të vendosur në nenin 2 të mëposhtëm.
- 1.2. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në këtë kontratë, do të lindin që nga momenti që shoqëria do të marrë të gjitha të drejtat për Konçesionin për shfrytëzimin e kromit Nr. 531, të lëshuar nga Ministria Ekonomisë dhe privatizimit të Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, pra në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate të drejtat dhe detyrimet mbi Konçesionin i zotëron shoqëria tregtare "SUPER BETON MATI" sh.p.k.
- 1.3. Shitësi është i detyruar ti transferojë blerësit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e kuotave të zotëruara prej tij dhe që do të shiten në favot të blerësit, me qëllim



regjistrimin e tyre në emër të blerësit pas blerjes në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Neni 2

Çmimi i transferimit të kuotave

- 2.1. Blerësi bie dakort dhe deklaron të bëjë pagesën prej 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë) Euro, për masën e 35% të kuotave që shitësi zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë RA KROM-TIRANA sh.p.k.

Neni 3

Pagesa

- 3.1. Blerësi është i detyruar, të paguajë çmimin e përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate, brenda 35 (tridhjet e pesë) muajve duke filluar që nga data e efektive e kësaj kontrate siç është parashikuar në dispozitën 1.2.
- 3.2. Blerësi është i detyruar që në datën 10 të çdo muaji, të kryejë një pagesë prej 100.000 (njëqind mijë) euro në favor të shitësit, për llogari të çmimit të përgjithshëm.
- 3.3. Çmimi i përgjithshëm i transferimit të kuotave, përfshin brenda tij të gjitha taksat, tatimet dhe shpenzimet e tjera. Blerësi nuk është i detyruar të paguajë ndonjë taksë që mund të kërkohej nga Banka e Shitësit për transferimin e çmimit të blerjes ose pjesëve të tij.
- 3.4. Çmimi i blerjes së kuotave apo ndonjë pjesë e tij e pasqyruar në këtë kontratë, do të kryhet nga blerësi nëpërmjet transfertave bankare në llogarinë Bankare të shitësit, të përcaktuar nga vetë shitësi si më poshtë.
- 3.5. Pagesa e çmimit të kësaj kontrate do të kryhet sipas kërkesave të legjislacionit në lidhje me këmbimin valutor. Blerësi paguan çmimin e përcaktuar në këtë kontratë në Euro, në rast se palët nuk do të vendosin për monedhë tjetër nëpërmjet një marrëveshjeje tjetër me shkrim. Në rast të pagesës së çmimit të përgjithshëm ose të ndonjë pjese të tij me ndonjë valutë tjetër, këmbimi në Euro bëhet sipas kursit valutor të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, në datën e transferimit të çdo shume përkatëse.

Neni 4

Lejet, licensat dhe autorizime

- 4.1. Blerësi duhet të marrë të gjitha lejet, licensat dhe autorizimet nga organet shtetërore kompetente, të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e kësaj kontrate, duke përfshirë por jo duke u kufizuar dhe agjencitë antimonopol, duke parashikuar se lëshimi i këtyre lejeve dhe licensave është i kërkuar nga legjislacioni përkatës në fuqi.
- 4.2. Në rast se Blerësi do të jetë i detyruar të nxjerrë leje sipas pikës 4.1 të këtij neni, shitësi do të jetë i detyruar të bashkëpunojë me Blerësin në procesin e nxjerrjes së këtyre lejeve dhe licensave duke përfshirë dhe sigurimin e informacioneve dhe dokumentacionit që mund të jetë i domosdoshëm për Blerësin.



Neni 5 **Transferimi i kuotave**

- 5.1. Palët kanë vendosur që Blerësi të marrë Kuotat e Shitësit duke paguar aq sa është vlera e shitjes.
- 5.2. Të drejtat e pronësisë së palës Shitëse që përbëjnë 5% të kapitalit themeltar të Shoqërisë i kalojnë Blerësit sa herë që pagesat ndaj Shitësit do të kryhen në përputhje me pikën 3.1.1. të kësaj Kontrate në masën 500 000 (pesë qind mijë) Euro.
- 5.3. Shitësi është i detyruar të paraqesë e të votojë në çdo mbledhje të përgjithshme të ortakëve të shoqërisë ku vendoset që të regjistrojë në Regjistrin Tregtar Shqiptar ndryshimet në lidhje me transferimin e Kuotave nga Shitësi tek Blerësi në përputhje me Pikën 5.2 të kësaj Kontrate.

Neni 6 **Përgjegjsia**

- 6.1. Në rast se pagesat e parshikuara sipas pikës 3.2 të kësaj Kontrate nuk kryhen në afat, atëherë do të zbatohet një interes vjetor prej 20% i cili do të llogaritet mbi shumën e detyrimeve të pashlyer. Gjithsesi në këtokushte Blerësi nuk humbet të drejtën për marrjen e kuotave të Shitësit.
- 6.2. Në rast se afati total për shlyerjen e detyrimeve të kuotave i tejkalon 48 (dyzet e tetë) muaj Shitësi ka të drejtë të refuzojë shitjen ndaj Blerësit për atë pjesë të mbetur të Kuotave të cilat nuk janë paguar në momentin e skadimit të afatit.

Neni 7 **Përfundimi i Kontratës**

- 7.1. Kjo Kontratë përfundon pasi Palët përmbushin të gjitha detyrimet e parashikuara në të. Asnjë Palë nuk ka të drejtë të prishi këtë Kontratë para afatit të skadimit të saj, ashtu siç është parashikuar në këtë nen, në rast se prishja nuk vendoset me miratim nga të dyja palët apo si dhe në rast se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në këtë Kontratë.

Neni 8 **Agjenti**

- 8.1. Me anë të kësaj Kontrate Blerësi autorizon Agjentin, i cili është entitet juridik i krijuar në përputhje me legjislacionin e Federatës Ruse:
Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Upravlyayushchaya Gornorudnaya Kompaniya" (Management Mining Company) – "Shoqëri në drejtimin e minerave(mineraleve)", me seli në adresën në vijim: 190005, Rusi, St-Peterburg 6 Krasnoarmeyskaya, 14, ap. 34.
Person i Kontaktit
Mr. Dimitriy Filichkin
Federata Ruse, St-Petersburg, Moskovskiy Prospect, 212, pjesa A,
Fax: (7812) 363 2003
për përmbushjen e akteve ligjore të përcaktuara në këtë kontratë.
- 8.2. Agjenti është i autorizuar nga Blerësi për veprimet në vijim (i) të vrojtojë për llogari të Shitësit respektimin e dispozitave të kësaj Kontrate; (ii) të marrë për llogari të Blerësit të gjitha njoftimet, të cilat Shitësi mund apo duhet të kryejë në përputhje me këtë Kontratë; (iii)



- të dërgojë në emër të Blerësit të gjitha njoftimet të cilat mund apo duhet të dërgohen në përputhje me këtë Kontratë.
- 8.3. Shitësi është i detyruar të njoftojë Agjentin për të gjitha rrethanat që ndikojnë në kushtet e kësaj Kontrate apo për mundësinë e Shitësit për të përmbushur kushtet e kësaj Kontrate. Të gjitha dokumentat dhe njoftimet dhe (ose) kopiet e tyre të cilat duhen transferuar nga Shitësi tek Blerësi sipas kësaj Kontrate do të konsiderohen të transferuara apo të paraqitura që nga momenti i dërgimit të këtij dokumenti tek Agjenti.

Neni 9 Dispozita të tjera

- 9.1 Gjuha e kontratës. Kjo kontratë është hartuar në gjuhët Anglisht, Shqip dhe Rusisht. Në rast ndryshimesh ndërmjet varianteve atëherë do të ketë prioritet varianti në Rusisht. Të gjitha dokumentat që duhet të paraqiten sipas kësaj Kontrate apo njoftimet që duhen dërguar ashtu sipas parashikimeve në këtë Kontratë do të përgatiten në gjuhën angleze ose, në rast se ato janë paraqitur në ndonjë gjuhë tjetër do të shoqërohen me përkthimin në gjuhën Angleze.
- 9.2 Të ndryshme. Për aq sa është e mundur secila prej dispozitave të kësaj Kontrate do të interpretohen në mënyrë të tillë që të jenë të vlefshme dhe në përputhje me të drejtën e zbatuar. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Kontrate nuk do të përmbushet apo është e pavlefshme sipas së drejtës së zbatuar, këto dispozita do të jenë të pavlefshme deri në atë masë sa ajo të bëhet e pavlefshme apo e papërmbushur, dhe dispozitat e tjera të Kontratës mbeten detyruese dhe të vlefshme. Në rast pamundësie në përmbushje apo pavlefshmërie të dispozitave përkatëse të kësaj Kontrate Palët janë të detyruar në mirëbesim që të arrijnë një marrëveshje në lidhje me ndryshimet apo shtesat në këto dispozita të cialt janë të nevojshme për realizimin e qëllimit të shprehur në këtë Kontratë përse ato kanë lidhje me dispozitat e pavlefshme apo të papërmbushura.
- 9.3 Kopiet. Janë përgatitur 6 (gjashtë) kopie të kësaj Kontrate nga të cilat 2 (dy) kopie në Rusisht, Shqip dhe Anglisht.
- 9.4. Njoftime. Çdo njoftim i cili duhet apo mund ti dërgohet çdo pale me korrespondencë sipas kësaj Kontrate konsiderohet e transferuar kur ajo (i) është dërguar personalisht, (ii) është dërguar me anë të një letre e regjistruar me postë të shpejtë ndërkombëtare, ose (iii) është dërfuar më teletekst, telegram apo faks (dhe, vetëm në rast se (iii) nëse konfirmohet njëkohësisht me anë të një letre të regjistruar ose me letër të dërguar me anë të një poste të shpejtë ndërkombëtare) ndaj Palës tjetër në adresën përkatëse të dhënë në vijim ose në ndonjë adresë të re të cilën secila Palë është e detyruar t'ia dërgojë Palës brenda 7 (shtatë) ditëve pas ndryshimit të secilës adresë.

(a) Blerësi:

Av. Dmitriy Kunis

Federata Ruse, St-Petersburg, Sestroretsk, Listvennaya St. 20 A;

Fax: (7 812) 633 35 58

(b) Shitësi:

Av. Gani Hoxha

Albania, Rr. "Karl Gega" Pall 3/1, Ap. 16, Sh. 1.

(c) Agjenti

Av. Dmitry Filichkin

Federata Ruse, St-Petersburg, Moskovskiy Prospect, 212, pjesa A,

Fax: (7812) 363 2003



- 9.5. Nryshime. Kjo Kontratë (përfshi çdo dispozitë të saj) nuk mund të ndryshohen, me përjashtim të rastit kur këto ndryshime bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga Palët.
- 9.6. Detyrat. Asnjë prej Palëve nuk ka të drejtë të kalojë të drejta apo detyrime të kësaj Kontrate pjesërisht ose tërësisht tek të tjerë pa një letër aprovimi paraprake nga Pala dhe në rast se këto kalime janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Kontrate atëherë ato janë të pavlefshme. Në rast se sipas këtij neni do të kalohet tek të tretët ndonjë detyrim në tërësi apo pjesërisht, pala që ka bërë kalimin nuk çlirohet nga detyrimet e parashikuara në këtë kontratë me përjashtim të rastit kur pala tjetër në këtë kontratë ka dhënë miratimin me shkrim për përjashtim nga përmbushja e detyrimit në fjalë.
- 9.7. Forca madhore. Në rast se për shkak të rrethanave që përbëjnë forcë madhore ndonjëra prej palëve nuk do të përmbushë detyrimin tërësisht apo pjesërisht, atëherë ajo nuk është e detyruar të përmbushë detyrimin përkatës për sa kohë zgjat ngjarja e forcës madhore. Kjo Palë gjithsesi, duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër me shkrim në lidhje me ngjarjen e forcës madhore dhe në rast se është e nevojshme të paraqesë një raport në lidhje me ecurinë e këtyre rrethanave. Pas përfundimit të forcës madhore, pala është e detyruar të përmbushë detyrimin saj në masën dhe mënyrën e që palët kanë patur si qëllim. Në këtë Kontratë forcat madhore përfshijë ngjarje të cilat janë të pavarura nga Palët të tilla si: veprimi i forcave të pavarura nga njerëzimi, akte, Urdhra, Ligje, Dekrete de-jure ose de-facto, vendime gjyqsore, rezoluta ose dispozita të ndonjë gjykate ose institucion të rëndësishëm, ngjarje natyrore të tilla si: tërmet, përmbytje, zjarr, rebelim, konflikte civile, lufta, mbytje anijeje ose aksident avionik, embargo për transporte për ngarkesa e embargo tëtjera ose greva.
- 9.8. Zgjidhja e mosmarrëveshjes
Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim (negocime nga ana e personave të autorizuar) dhe brenda një periudhe të përshtatshme të gjitha mospërputhjet apo mosmarrëveshjet të mund të lindin nga kjo kontratë. Dispozita vendos mbi Palën detyrimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim. Në rast se një problem nuk mund të zgjidhet gjatë 15 ditëve kalendarike nga moment kur mosmarrëveshja është shfaqur, kjo do të thotë se nuk mund të arritet një zgjidhjen me mirëkuptim dhe çështja mund t'ë dërgohet gjykatës kompetente për shqyrtim, në përputhje me dispozitën 9.9 të kontratës.
- 9.9. Gjykimi. Të gjitha mosmarrëveshjes dhe mospërputhjet që rezultojnë nga kjo kontratë do të jenë në kompetencë të Gjykatës së Arbitrazhit të Shqipërisë në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale të Legjislacionit Shqiptar.
- 9.10. Përfundimi i Kontratës. Kontrata konsiderohet e përfunduar detyruese për të dyja palët nga momenti i vendosur në dispozitën 1.2 në këtë Kontrakt.

Vërtetohet, se kjo Kontratë është nënshkruar nga Palët dhe në emër të tyre në Tiranë, Shqipëri, në datën, afër nënshkrimeve të palëve si më poshtë.

Firma e palëve dhe data e nënshkrimit

BLERËSI
(firma)

02/07/2008

SHITËSI
(firma)

02/07/2008



Akt Kontrolli i pagesave
sipas gjendjes së llogarisë më 20 Gusht të vitit 2010

" 20 " Gusht 2010.

Ky akt kontrolli është hartuar ndërmjet:

Shoqërisë **STARLEAD LTD**, person juridik, regjistruar sipas legjislacionit të Ishujve Virgine të Britanisë, me seli në: Chambers, 197 Main Street, P.O. Box 3174, Road Town, Tortola, British Virgin Islands, përfaqësuar nga z. Kunis D.M., që vepron në bazë të prokurës me datë 3 gusht 2009, më poshtë referuar si "**Blerësi**",

dhe

z. Gani Hoxha, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me numër Z1950841, me adresë në: Rruga "Karl Gega", Pall 3/1, Ap 16, Sh.1, Tiranë, Shqipëri, që vepron bashkë me bashkëshorten e tij **znj. Natasha Hoxha**, shtetase shqiptare, me adresë në: Rruga "Karl Gega", Pall 3/1, Ap 16, Sh.1, Tiranë, Shqipëri, më poshtë referuar si "**Shitësi**", që janë palë sipas Kontratës së Shit-Blerjes së kuotave, me datë 02.07.2009 (më poshtë referuar si "Kontrata") dhe më poshtë së bashku referuar si "Palët".

Nëpërmjet këtij Akti Palët konfirmojnë, se Blerësi i ka kryer pagesat, kurse Shitësi i ka marrë këto të fundit për blerjen e një pjesë kuotash të kapitalit fillestar të shoqërisë "RA Krom-Tirana" në përputhje me Kontratën.



Pagesa		
Data	Shuma, Euro	Përshkrimi
28.04.2009	100 000	TTO140/113555
05.06.2009	50 000	TTO140/152106
06.07.2009	50 000	TTO140/182680
03.08.2009	50 000	TTO140/213053
04.09.2009	100 000	TTO140/248705
05.10.2009	100 000	TTO140/280790
06.11.2009	85 000	TTO140/317622
09.11.2009	15 000	TTO140/320332
30.12.2010	100 000	TTO140/387162
22.01.2010	100 000	TTO140/404667
12.02.2010	50 000	TTO140/433836
15.03.2010	50 000	TTO140/468427
18.03.2010	100 000	TTO140/468427
09.04.2010	100 000	TTO140/498737
07.05.2010	60 000	TTO140/533539
17.06.2010	60 000	TTO140/581723
30.06.2010	60 000	TTO140/598611
Gjithsej:	1 230 000	

Gjithsej deri më datë 02.08.2010 për blerjen e kuotave janë paguar 1 230 000 (një milion dyqind e tridhjetë mijë) euro.

Në përputhje me pikën 5.2 të Kontratës "E drejta e pronësisë për një pjesë të kuotave, që përbën 5% të kapitalit fillestar të Shoqërisë, kalon nga Shitësi te Blerësi, çdo herë me pagesën që i bëhet Shitësit sipas pikës 3.1.1. të kësaj Kontrate, të shumës 500 000 (pesëqind mijë) EURO". Në këtë mënyrë, e drejta e pronësisë i kalon Blerësit prej datës 09.04.2010. Në këtë rast Shitësi ka marrë një paradhënie për pagesat e ardhshme sipas Kontratës në shumën e 230 000 (dyqind e tridhjetë mijë) euro.

STARLEAD LTD.
Kunis D. M.




Gani Hoxha

Natasha Hoxha

Reconciliation act
for the 20th of August, 2010

August 20, 2010

The present reconciliation act is drawn up by

the Company of **STARLEAD LTD**, being a legal entity by the legislation of The British Virgin Islands, registered at the following address: Chambers, 197 Main Street, P.O. Box 3174, Road Town, Tortola, British Virgin Islands, represented by Mr. Dmitry Kunis, acting on the base of the Power of attorney dated by the 3rd of August 2009, hereinafter referred to as the «**Buyer**», on the one side,

and
Mr. Gani Hoxha, citizen of the Republic of Albania, passport Z1950841, residing at the following address: Albania, Rruga "Karl Gega", Pall 3/1, Ap 16, Sh.1, acting jointly with his spouse **Mrs. Natasha Hoxha**, the citizen of the Republic of Albania, residing at the following address: Albania, Rruga "Karl Gega", Pall 3/1, Ap 16, Sh.1, named as the «**Seller**», on the other side,

being the Parties in accordance with the Contract of purchase and sale of the share dated by the 2nd of July, 2007 (further referred to as "Contract") and further jointly named as «Parties».


By the present reconciliation act the Parties confirm that the Buyer has delivered the payment and the Seller received the payment for the purchase and sale of the share of "RA Krom-Tirana" Shpk charter capital in full compliance with the Contract.

Payment		
Date	Amount, Euro	Sender's Reference
28.04.2009	100 000	TTO140/113555
05.06.2009	50 000	TTO140/152106
06.07.2009	50 000	TTO140/182680
03.08.2009	50 000	TTO140/213053
04.09.2009	100 000	TTO140/248705
05.10.2009	100 000	TTO140/280790
06.11.2009	85 000	TTO140/317622
09.11.2009	15 000	TTO140/320332
30.12.2010	100 000	TTO140/387162
22.01.2010	100000	TTO140/404667
12.02.2010	50000	TTO140/433836
15.03.2010	50000	TTO140/468427
18.03.2010	100000	TTO140/468427
09.04.2010	100000	TTO140/498737
07.05.2010	60000	TTO140/533539
17.06.2010	60000	TTO140/581723
30.06.2010	60000	TTO140/598611
Total:	1 230 000	

Thus for the date of August 02, 2010 the payment delivered for the purchase and sale of the share is equal to 1 230 000 (One million two hundred thirty thousand) Euro.

In compliance with point 5.2 of the Contract "Property right on the part of the Seller share making 5 % of the Company charter capital passes to the Buyer each time when payments to the Seller in accordance with p. 3.1.1 of the present Contract will achieve sums in volume 500 000 (five hundred thousands) EURO.". Thus the property right for 5% of "RA Krom-Tirana" Shpk charter capital was transferred to the Buyer on the 9th of April 2010. By the present reconciliation act the Buyer also confirms the receipt of a payment of 230 000 (Two hundred thirty thousand) euro, which is regarded as a future payment due to the Contract.

STARLEAD LTD.
Mr. Dmitry Kunis



Gani Hoxha
Mr. Gani Hoxha

Natasha Hoxha
Mrs. Natasha Hoxha